

Aneksi A

SHPLLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Shpallja e vendeve të lira të punës do të bëhet nga MM/SHP ose Komandat e forcave/Komandat mbështetëse nëpërmjet QKMB&MSHP-së, e cila përgjigjet për publikimin e vëndit të lirë të punës në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në bazë të kërkesave që komandat/strukturat dërgojnë për shpalljen e vendeve të lira të punës QKMB&MSHP bën publikimin e tyre, duke përdorur formatin e dhënë në tabelën 1.

Për shpalljen e një pozicioni konkret me kërkesat e pozicionit ajo do të përdorë formularin nr. 1, i cili shfaqet duke klikuar tek emërtimi i pozicionit të shpallur.

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar / Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me do sje	Intervi sta	Fillimi	Mbarimi
1	“Teknik i Mesëm (Gomist/Lavazhier)”	Reparti Ushtarak nr.6630 Batalioni i Mbështetjes së SHPFA	Rruga “Teki Selenica” Rrapi i Treshit. Tiranë	Pa afat	po	jo	31.08.2026	14.09.2026

Formulari nr.1 plotësohet nga komanda/struktura e interesuara për shpalljen e vëndit të lirë të punës dhe i dërgohet zyrtarisht QKMB&MSHP. Kjo e fundit bën publikimin e tij në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes brenda afateve të përcaktuara.

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Teknik i Mesëm (Gomist Lavazhier)
2. Kodi i pozicionit: LR 2410
3. Reparti/Institucioni: Reparti Ushtarak nr.6630, Batalioni i Mbështetjes së SHPFA
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.84 datë 06.02.2026 “Për pagat e punonjësve mbështetës”
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat

7. Data e fillimit të aplikimit: 31.08.2026
8. Data e mbylljes së aplikimit: 14.09.2026
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njësisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (Rruga “Teki Selenica” Rrapi i Treshit Tiranë):
10. Dokumentet e aplikimit: Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: ▪ kërkesën; ▪ formularin e aplikimit; ▪ fotokopje të kartës së identitetit; ▪ diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare profesionale ose të lartë të noterizuar ose në origjinal; ▪ fotokopje të patentës nëse ka; ▪ dëshmi profesioni nëse ka; ▪ certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja ▪ raport mjekësor; ▪ fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; ▪ dëshmi penaliteti; ▪ vërtetim nga gjykata; ▪ vërtetim nga prokuroria; ▪ librezë pune; ▪ jetëshkrimin (CV). ▪ formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike ee.mod.gov.al. (linku: <i>Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit</i>)
11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës: a) të ketë shtetësinë shqiptare; b) të jetë jo më pak se 18 vjeç; c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar; d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara; ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore; e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi; - dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.
12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës: a. Grada/Titulli: C2 b. Arsimi i mesëm c. Kualifikimi: d. Trajnimi:

- e. Eksperienca në Punë:
- f. Gjuha e huaj:
- g. Kërkesa të tjera specifike:
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë:

Përshkrimi i punës:

“Teksnik i Mesëm (Gomist Lavazhier)” në Kompaninë e Mbështetjes të BmSHPFA përgjigjet për gjendjen e gomave si dhe higjenën e automjeteve

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- përzgjedhje me dosje.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- Vlerësim me dosje.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 100 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.